



Water and Waste Regulatory Office
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad

UNMIK



ZRRUM – R 07 / W&WW

ZYRA E RREGULLATORIT PËR UJË DHE MBETURINA (“ZRRUM”)

RREGULL

PËR

**AMNESTINË PËR KYÇJET E PALIGJSHME NË SHËRBIMET
PUBLIKE TË UJIT**

NGA

**OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË
KOSOVË**

26 Janar 2005

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	3
Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull.....	3
Neni 2: Synimi	3
Neni 3: Qëllimi.....	3
Neni 4: Përkufizimet	3
Neni 5: Rregullat e Interpretimit	5
Neni 6: Aplikueshmëria	6
PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME	6
Neni 7: Ndalimi i Kyçjeve të Paligjshme.....	6
Neni 8: Qëllimi dhe Kushtet për Amnesti për Kyçjet e Paligjshme	7
Neni 9: Pagesat për të Zgjidhur Kyçjet e Paligjshme	7
Neni 10: Mungesa e Pëlqimeve për Ndërtime	8
Neni 11: Kyçjet e Paligjshme në Pronat e Dhëna me Qira ose të Marrura me Qira.....	8
Neni 12: Personi i Cenueshëm	9
Neni 13: Depozitet për Garanci.....	9
PJESA III: VËNIA NË JETË DHE DËNIMET	9
Kapitulli 1: Vënia në Jetë nga Rregullatori.....	9
Neni 14: Vënia në Jetë e Amnestisë për Kyçje të Paligjshme	9
Kapitulli 2: Raportet dhe Shënimet e Kyçjeve të Paligjshme	9
Neni 15: Shënimet dhe Raportet mbi Kushtet e Licencës së Shërbimit	9
Kapitulli 3: Kundërvajtjet dhe Dënimet.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 16: Kundërvajtjet dhe Dënimet	Error! Bookmark not defined.
PJESA IV: TË NDRYSHME.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 17: Gjuhët Zyrtare të këtij Rregulli	Error! Bookmark not defined.
Neni 18: Hyrja në Fuqi.....	Error! Bookmark not defined.

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori lëshon këtë Rregull nën autorizimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Hedhurinave në Kosovë.

Neni 2: Synimi

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që aktualisht punojnë duke ofruar Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë do të zbatojnë këtë Rregull vetëm një herë për amnestinë, inspektimin dhe zgjidhjen e Kyçjeve të Paligjshme.

Neni 3: Qëllimi

- 3.1 Qëllimi i kësaj Rregulle është të ofrohen afatet për individët që të përfitojnë vetëm një herë nga amnestia për Kyçjet e Paligjshme.
- 3.2 Pranueshmëria për amnestinë në bazë të kësaj Rregulle është e kushtëzuar me njohjen e Konsumatorit për përgjegjësinë e tij ose të saj për të paguar Faturat aktuale dhe të gjitha Faturat dhe të lidhë marrëveshjen me shkrim me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit për atë qëllim siç është e paraqitur në këtë Rregull.

Neni 4: Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

Borxhi i Vjetër nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorit të evidentuara nga faturat e pakontestueshme të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit të Konsumatorit më ose pas 31 dhjetorit 2002, të cilat nuk janë paguar në tërësi siç janë definuar dhe rregulluar në Rregullën e caktuar për Borxhet e Vjetra të lëshuar, ndryshuar apo plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Depoziti për Garanci nënkupton depozitin e kërkuar Ofruesi i Shërbimeve të Ujit;

Ditë Pune nënkupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;

Fatura nënkupton njoftimin me shkrim që i është lëshuar Konsumatorit për të paguar Shërbimet e Ujit dhe/ose për cilatdo shërbime që ngarkohen së bashku me shumën që është e caktuar për t'u paguar për ofrimin e Shërbimeve të Ujit, e cila specifikon shumën e pagueshme dhe atë që është në borxh, dhe për periudhën për të cilën janë ofruar Shërbimet e Ujit, të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit tek Konsumatori sipas rregullave të përcaktuara për atë qëllim kohë pas kohe nga Rregullatori;

Karta e Konsumatorëve nënkupton dokumentin e përgatitur nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe i cili i bëhet i ditur çdo Konsumatori ku radhiten të drejtat dhe obligimet e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Konsumatorit ndaj njëri tjetrit;

Konsumator nënkupton çdo person që ka lidhë Kontratën për Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza apo kontratën për Furnizim me Ujë me Shumicë që në mënyrë të ligjshme ka marrë Shërbime për Ujë të furnizuara nga Ofruesi i Shërbimeve;

- i. Konsumator Shtëpiak** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- ii. Konsumatori Komercial/Industrial** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumatori i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- iii. Konsumator Institucional** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste

Komisioni Konsultativ i Konsumatorëve nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori për secilin Zonë të Shërbimeve për të hulumtuar dhe zgjidhur Ankesat e Konsumatorëve dhe për të drejtuar analizat për Shërbimet e Ujit;

Komuna nënkupton çdo njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes në Kosovë që operon sipas Rregullore së UNMIK-ut Nr. 2000/45 të datës 11 gusht 2000 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë;

Kontratë për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza nënkupton kontratën e standardeve e cila do të lidhet në mes Ofruesve të shërbimeve të Ujit dhe Konsumatorëve që drejton furnizimin e Shërbimeve të Ujit dhe të drejtat dhe obligimet e palëve në atë kontratë të krijuar në lidhje me ofrimin e shërbimeve në fjalë, ose në mungesë të një kontrate me shkrim të tillë, afatet dhe kushtet e standardeve të furnizimit të Shërbimeve të Ujit të ushtruara nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit tek Konsumatorët e vet;

Kontratë për Shërbime nënkupton marrëveshjen në mes Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Konsumatorit të tij ose, nëse nuk ka një marrëveshje të tillë, kushtet për furnizim të Ofruesit të Shërbimeve;

Kyçje e Ligjshme nënkupton:

- i. ndërlidhjen në mes të objekteve të Konsumatorit që është në Regjistrin e Konsumatorëve dhe rrjetit shpërndarës për Shërbime të Ujit të kryer nga ai Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza; ose
- ii. ndërlidhjen në mes të objektit të Personit dhe rrjetit shpërndarës të krijuar nga Ofruesit përkatës i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose paraardhësve të tij sipas ligjit të aplikueshëm, dhe "I Kyçur Ligjshëm" do të ketë kuptimin e njëjtë.

Kyçje e Paligjshme nënkupton lidhjen në mes pronës së Konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të Shërbimeve të Ujit të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që nuk është krijuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose paraardhësit e tij sipas ligjit të aplikueshëm, dhe "i Kyçur Paligjshëm" do të ketë kuptimin e njëjtë;

Marrëveshja për Pagesë nënkupton marrëveshjen për të paguar Borxhin e Vjetër që lidhet në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit, të definuar dhe të rregulluar në Rregullën e caktuar për Borxhet e Vjetra të lëshuar, ndryshuar dhe/apo të plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Mbyll nënkupton ndërprerjen e furnizimit të ujit tek konsumatori pa e prerë apo dredhur në mënyrë fizike cilëndo pjesë të Gypit të Kyçjes së Konsumatorit;

Ndërmarrje Publike nënkupton ndërmarrjen e cila ishte e krijuar si ndërmarrje e pronës shoqërore në Kosovë, ashtu siç përcaktohet në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të 13 qershorit 2002 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”;

Ofrues i Shërbimeve të Ujit nënkuptojnë të gjitha ndërmarrjet ose agjencitë qeveritare të angazhuara në ofrimin e Shërbimeve të Ujit.

Pëlqimi për Ndërtim nënkupton autorizimin prej autoriteteve përkatëse për të ndërtuar;

Person nënkupton një individ, subjekt ligjor apo publik duke përfshirë korporatë, ortakëri, trust, një organizatë jo të inkorporuar, qeveri apo agjenci ose nënsektor prej kësaj;

Person i Cenueshëm nënkupton

- i. cilindo Person natyral të çertifikuar nga mjeku i licencuar që mund të i rrezikohet jeta apo shëndeti pa Shërbime për Ujë;
- ii. Cilido Konsumatori i klasifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si i varfër dhe skamnor, dhe që i këshillohet Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza si një që ka të drejtë që fatura e tij të paguhet nga autoritetet kompetente të mirëqenies sociale.

Periudha e Amnestisë nënkupton, sa i përket Kyçjeve të Paligjshme, periudhën prej katër (4) muajve duke filluar nga data kur hyn në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Hedhurinave në Kosovë.

Rregullator nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit;

Rrjeti i Ujit nënkupton të gjitha mjetet themelore të përdorura për dhe/apo në lidhje me ofrimin dhe/apo marrjen e Shërbimeve të Ujit qoftë atyre që i takojnë sferës publike ose për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit;

Shërbimet e Ujit nënkupton shërbimet publike të abstragimit, përpunimit, bartjes dhe shpërndarjes së ujit për konsum njerëzor dhe

Shkyçje nënkupton ndërprerjen e lidhjes në mes objektit të Konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për Shërbimet e Ujit nëpërmjet të së cilës lidhje Konsumatori i merr ato shërbime nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe “Shkyç” do të ketë kuptim të ngjashëm;

Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, të cilat nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Hyrjen e kësaj Rregulle dhe/ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull do të interpretohen sipas kuptimit të cilitdo Rregull të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me pushtetin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët që përdoren në cilëndo gjini do të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe

Neni 6: Aplikueshmëria

Të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë që tani ofrojnë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të respektojnë dispozitat e kësaj Rregulle në mënyrë që të mos jenë diskriminuese për të gjithë Konsumatorët.

PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 7: Ndalimi i Kyçjeve të Paligjshme

Personat që janë kyçur në Rrjetin e Ujit përmes Kyçjes së Paligjshme konsiderohen se janë duke bërë kundërvajtje që dënohet me vënien e gjobës nga Rregullatori sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Hedhurinave në Kosovë të referuar në Nenin 1 të këtij Rregulli.

- 7.1. Për të mënjeluar dyshimin, kyçja e sërishme e bërë pa pëlqimin ose që nuk është e bërë përmes Ofruesit të Shërbimeve të Ujit, gjithashtu çdoherë do të konsiderohet si Kyçje e Paligjshme e ndaluar, edhe atëherë kur Konsumatori ka pasë Kyçjen e Ligjshme.
- 7.2. Gjobat e caktuara për t'u paguar për vendosje, rivendosje dhe/ose mirëmbajtje të Kyçjeve të Paligjshme do të vihen nga Rregullatori sipas rregullës specifike të lëshuar, ndryshuar dhe/ose të plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori për atë qëllim.
- 7.3. Gjobat e ngarkuara për Kyçje të Paligjshme, do të jenë posaçërisht të ashpërsuara, ndër situatat tjera serioze të definuara kohë pas kohe nga Rregullatori, sa herë që vendosja, rivendosja dhe/ose mirëmbajtja e atyre Kyçjeve të Paligjshme do të konsiderohet se:
 - (a) Krijon rrezik për shëndetin publik për të gjithë shfrytëzuesit nëpërmes të kontaminimit të mundshëm të furnizimit me ujë për shkak të kyçjeve të kryqëzuara dhe përzierjes me ujëra të zeza; dhe/ose
 - (b) Çrregullon hidraulikën e rrjedhjes së ujit, duke zvogëluar sasinë e disponueshme dhe duke shkaktuar dëmtimin fizik në cilëndo pronë publike dhe/ose private dhe/ose objekte dhe/ose në Rrjetin e Ujit.

Neni 8: Qëllimi dhe Kushtet për Amnesti për Kyçjet e Paligjshme

- 8.1 Qëllimi për këtë amnesti është të zgjidhë Kyçjet e Paligjshme për të cilat Ofruesi i Shërbimeve të Ujit nuk është në dijeni ose që paraprakisht nuk ka dhënë aprovimin ose Personit nuk i ka ofruar Faturë për shërbimet e ujit.
- 8.2 Pranueshmëria për amnestinë në bazë të kësaj Rregulle është e kushtëzuar me pranimin e Personit mbi përgjegjësinë e tij ose të saj për të paguar të gjitha Faturat dhe për të bërë marrëveshjen me shkrim me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për atë qëllim.
- 8.3 Nëse Personi kontakton me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe të Ujërave të Zeza brenda Periudhës së Amnestisë për të informuar lidhur me ekzistimin e Kyçjes së Paligjshme, dhe nënshkruan Kontratën për Shërbimet me Ujë me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe të Ujërave të Zeza, nuk do të aplikohet kurrfarë dënimi ndaj atyre Kyçjeve të Paligjshme të zbuluara.
- 8.4 Kur një Kyçje e Paligjshme është e zbuluar nga Ofruesi i Shërbimeve ose i raportohet Ofruesit të Shërbimeve pas Periudhës së Amnestisë, atëherë Personi duhet patjetër të paguajë dënimin dhe pagesat për ujin e përdorur dhe për rehabilitimin e kyçjes në Rrjetin e Ujit siç është e përkrahur në Nenin 9.5.

Neni 9: Pagesat për të Zgjidhur Kyçjet e Paligjshme

- 9.1 Një person me Kyçje të Paligjshme është i detyruar të paguajë për ujin e përdorur për periudhën në mes të 1 janarit 2002 dhe datën kur Personi e nënshkruan Kontratën për Shërbime të Ujit me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit, përveç nëse Personi mund të dëshmojë banimin që ka filluar në datë më të vonshme.
- 9.2 Për qëllimet të cekura më lartë në Nën-nenin 9.1, data e banimit mund të dëshmohet me:
 - (a) datën e parashtrimit të aplikacionit për Shërbime të Ujit të dorëzuar nga ana e Konsumatorit të Ofruesi i Shërbimeve të Ujit; ose
 - (b) datën e parashtrimit të aplikacionit për shërbime të paraqitura nga Konsumatori për rrymë ose për shërbime të ngrohjes qendrore; ose
 - (c) emrin dhe datën e regjistrimit të Pasurisë së Patundshme; ose
 - (d) cilindo dokument tjetër zyrtar që mund të shërbejë për të dëshmuar datën e banimit.
- 9.3 Koha e banimit do të jetë e llogaritur në njësi të muajve të plotë duke filluar me muajin e parë të plotë të banimit. Ditët më pak se një muaj do të jenë të shpërndara proporcionalisht duke u bazuar në muajt 30-ditësh.
- 9.4 Llogaritja e shumës për t'u paguar do të bazohet në sasinë e ujit ose në mesataren e shumës së faturës mujore për Konsumatorë të ngjashëm (si këta) të shërbyer nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit.
- 9.5 Për sa i përket afateve dhe kushteve të Kontratës për Shërbimin me Ujë, Konsumatori do të paguajë rehabilitimin e Kyçjeve të Paligjshme për t'i

- përmbushur standardet teknike dhe ato të punës të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit të cilët mund të kërkojnë pagesë për këtë inspektim dhe për çfarëdo rehabilitime të nevojshme.
- 9.6 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit mund të pajtohet me një Marrëveshje për Pagesë të arsyeshme me Konsumatorin dhe të lidhë Kontratë për Borxhin e Vjetër sipas Rregullës “Mbi Faljen dhe Shlyerjen e Borxheve të Vjetra” të lëshuar, ndryshuar dhe/ose të plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori.
- 9.7 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet që Konsumatorit të ia konfirmojë me shkrim të gjitha Marrëveshjet për Pagesë sipas dispozitave të Rregullës “Mbi Faljen dhe Shlyerjen e Borxheve të Vjetra” të lëshuar, ndryshuar dhe/ose të plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori.

Neni 10: Mungesa e Pëlqimeve për Ndërtime

- 10.1 Amnestia për Kyçje të Paligjshme do të u ipet atyre Personave në Ndërtesa ose në Prona të cilët nuk posedojnë Pëlqimin për Ndërtim nga autoritetet përkatëse nëse Personi është në pajtueshmëri me kërkesat në këtë Rregull.
- 10.2 Kjo amnesti në asnjë mënyrë nuk prek cilindo veprim që Komuna do të ndërmerr ose nuk do të ndërmerr lidhur me mungesën e Pëlqimit të duhur për Ndërtim, dhe nuk e bën ndërtesën legale.
- 10.3 Nëse Komuna jep urdhër që ndërtesa të rrëzohet, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit do të heq lidhjen e asaj ndërtese në Rrjetin e Ujit sa më parë që mund të zbatohet.

Neni 11: Kyçjet e Paligjshme në Pronat e Dhëna me Qira ose të Marrura me Qira

- 11.1. Pronari dhe/ose Personi i cili në mënyrë të ligjshme vepron si qiradhënës i pronës së dhënë ose të marrur me qira është i mbuluar nga ky Rregull duke siguruar se ai raporton te Ofruesi i Shërbimeve të Ujit lidhur me Kyçjen e Paligjshme.
- 11.2. Kur një ose më shumë qiraxhi raportojnë Kyçjet e Paligjshme për pronën e dhënë ose të marrur me qira, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit do të përpiqet të kontaktojë pronarin ose cilindo Person që në mënyrë të ligjshme vepron si qiradhënës për të zgjidhur Kyçjen e Paligjshme.
- 11.3. Nëse përpjekjet në Nenin 11.2 dështojnë, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të dërguar njoftimin të së paku një banor i rritur në secilën banesë. Lidhur me ndërtesat banesore me vetëm një kyçje të shërbimit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza gjithashtu do të vendosë njoftimin në ose afër hyrjes së banesës ose banesave të prekura.
- 11.4. Njoftimi i referuar në Nën-nenin 11.3. të lartshënuar duhet të informojë qiraxhiun se Kyçjet e Paligjshme mund të zgjidhen nëse një ose më shumë qiraxhi, në marrëveshje me tërë ndërtesën, të lidhin Kontratën për Shërbime të Ujit me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit.

- 11.5. Në rastin e paraparë në Nën-nenin 11.4 të lartshënuar, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit do të bëjë përpjekje të negociojë shlyerjen e arsyeshme të Borxheve të Vjetra të përcaktuar sipas Nenit 9.1 me qiraxhiun ose qiraxhinjtë të cilët dëshirojnë të zgjidhin Kyçjet e Paligjshme në marrëveshje me tërë ndërtesën.

Neni 12: Personi i Cenueshëm

- 12.1. Nga Personat e Cenueshëm nuk do të kërkohet të paguajnë cilindo Borxh të Vjetër.
- 12.2. Pavarësisht nga Nën-neni 12.1 i lartshënuar, Personat e Cenueshëm do të jenë të detyruar të paguajnë cilëndo Faturë që u lëshohet atyre nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit që përmendet në Shërbimet e Ujit të ofruara nga 1 janari 2003.

Neni 13: Depozitet për Garanci

- 13.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit do të ketë të drejtë të kërkojë nga Konsumatori i cili më herët ka pasur Kyçje të Paligjshme të paguajë Depozitin për Garanci ndaj Shërbimeve të Ujit në të ardhmen që ofrohen me kredi.
- 13.2 Shuma e atij Depoziti për Garanci do të përcaktohet dhe ai depozit do të shfrytëzohet për dispozitat lidhur me Depozitet Garantuese të përcaktuara në Rregullën "Mbi Shkyçjen e Shërbimeve të Ujit" të lëshuar, ndryshuar dhe të plotësuar kohë pas kohe nga Rregullatori.

PJESA III: VËNIA NË JETË DHE DËNIMET

Kapitulli 1: Vënia në Jetë nga Rregullatori

Neni 14: Vënia në Jetë e Amnestisë për Kyçje të Paligjshme

- 14.1 Rregullatori do të monitorojë respektimin e kësaj Rregulle në bazë të raporteve të dërguara kohë pas kohe nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit të përcaktuar nga Rregullatori sipas Neni 15 të më poshtëshënuar.
- 14.2 Rregullatori gjithashtu do të monitorojë pajtueshmërinë me këtë Rregull me anë të inspektimeve dhe analizave dhe nga raportet e dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet publike.

Kapitulli 2: Raportet dhe Shënimet e Kyçjeve të Paligjshme

Neni 15: Shënimet dhe Raportet mbi Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 15.1 Secili Ofrues i Shërbimeve të Ujit do të përgatitë dhe dorëzojë raportet te Rregullatori në formën e parashkruar dhe brenda intervaleve të specifikuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 15.2 Gjatë Periudhës së Amnestisë, secili Ofrues i Shërbimeve të Ujit do të dorëzojë te Rregullatori Raportin e Progresit, jo më vonë se në ditën e 15 të muajit vijues.
- 15.3 Dy muaj pas Periudhës së Amnestisë, secili Ofrues i Shërbimeve të Ujit do të dorëzojë te Rregullatori Raportin Përmbledhës.

- 15.4 Lokacioni dhe Mbajtja e Shënimeve: Të gjitha shënimet duhet të mbahen në zyrën kryesore të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe do të jenë në dispozicion gjatë ditëve të rregullta të punës për t'u kontrolluar nga Rregullatori.
- 15.5 Periudha e Ruajtjes së Shënimeve dhe Raporteve: Të gjitha shënimet dhe raportet e parashikuara në këtë Nen duhet të organizohen dhe të ruhen nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit për së paku dy (2) vite kalendarike nga data kur janë përgatitur për të parën herë ose të caktueshme përveç nëse ndonjë ligj tjetër i aplikueshëm e përcakton se duhet të mbahen për një periudhë kohore më të gjatë në cilin rast do të zbatohet periudha e fundit e përmendur për ruajtje.

Kapitulli 3: Kundërvajtjet dhe Dënimet

Neni 16: Kundërvajtjet dhe Dënimet

- 16.1 Gjjobat për Kyçje të Paligjshme do të vihen sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 "Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Medhurinave në Kosovë" dhe me cilatdo Rregulla tjera procedurale të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe.


PJESA IV: TË NDRYSHME

Neni 17: Gjuhët Zyrtare të këtij Rregulli

- 17.1. Ky Rregull lëshohet dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:
- (a) Angleze;
 - (b) Shqip; dhe
 - (c) Serbe.
- 17.2. Në rast të ndonjë mos përputhjeje në mes të versioneve në të cilat ky Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Angleze do të mirret si bazë.

Neni 18: Hyrja në Fuqi

- 18.1. Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit.
- 18.2. Ofruesi e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të përfundojnë këtë program të amnestisë për Kyçjet e Paligjshme brenda Periudhës së Amnestisë.



Paulino Brillhante Santos
Drejtore



Afrim Lajci
Zëvendës Drejtore

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina